

Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit: “Për kontrollin e kufirit shtetëror”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për kontrollin e kufirit shtetëror” ka si qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit kufitar dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror. Synimi i nismës ligjore është përmbushja e objektivave afatgjatë të përcaktuar në programin e qeverisë, konkretisht objektivi “Politika e Jashtme dhe e Sigurisë, si dhe integrimi evropian”.

Në veçanti, objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë kryesisht, por pa u kufizuar, si më poshtë:

1. Përforcimi i kontrollit dhe mbikëqyrja e kufijve, parandalimi dhe goditja e krimit ndërkufitar, parandalimi i migracionit të paligjshëm, rritja e parametrave të sigurisë kufitare dhe kombëtare;
2. Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe të Schengen, në aspektin legjislativ, administrativ e institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, forcimi i bashkëpunimit mes agjencive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;
3. Krijimi i Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, në përputhje me Rregulloren e EUROSUR;
4. Rregulloret e miratuara me VKM mbi përcaktimin e rregullave të trafikut lokal të kufirit, procedurave të lëshimit, formës, elementëve të sigurisë dhe specifikimeve teknike të lejes së trafikut lokal të kufirit;
5. Rritja e sigurisë në zonën e verifikimit kufitar;
6. Përmirësimi i sistemit për mbikëqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim shpëtimit në det;
7. Përcaktimi i rregullave të qarkullimit lokal kufitar, duke sanksionuar zbatimin e qarkullimit lokal kufitar, regjimin e qarkullimit lokal kufitar, pajisjen me lejen e qarkullimit lokal kufitar, kushtet, përmbajtja, forma dhe elementet e sigurisë së lejes së qarkullimit lokal kufitar si dhe lehtësimi i qarkullimit lokal kufitar.

Në vijim të sa më sipër, projekt-akti u publikua për konsultim publik në platformën RENJKP gjatë periudhës 19 gusht 2024 deri më 16 shtator 2024. Gjatë kësaj periudhe, projekti pati 294 lexime, por nuk u regjistrua asnjë koment nga përdoruesit e platformës.

Drafti i projektaktit i është dërguar nëpërmjet postës elektronike Delegacionit Europian, në Tiranë, për të cilin u shprehën dakord.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e projektligjit “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, janë përdorur katër metoda të ndryshme konsultimi. Më poshtë gjeni një përshkrim të detajuar për secilën nga këto metoda:

1. Përdorimi i Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, prej datës 19 gusht 2024 deri më 16 shtator 2024, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projekt aktin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm, nr. 26, datë 19.1.2024, “Për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar, i ndryshuar””. Këto takime përfshijnë mbledhje të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projektaktit dhe diskutime të detajuara mbi politikat e propozuara.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projekt aktin, por gjithashtu edhe për shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit;
4. Takime dhe tryeza teknike me përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Autoriteti i Kombëtar i Ushqimit dhe Doganat.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme në MB;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Institucionet e përfshira në zbatim të urdhrit të MB (anëtarë të grupit të punës);

- Ekspertët e Delegacionit European, në Tiranë;
- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJKP.

5.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi